



KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE S-H
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C
KOSOVSKO PREDUZECE ZA DISTRIBUCIJU I SNABEVANJE ELEKTRICNOM ENERGIJOM D.D.
KEDS - SH.A.

Nr. 22/02 Dt. 19.02.2020
HQ 3

DATË 19.02.2020

**KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE
SH.A.**

-dhe-

ELEKTRO AM sh.p.k

Kontratë për furnizim me ndërprerës të tensionit të mesëm

RfQ No. 11/01 2020

KONTRATË

Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a., (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues" ose AK), në njëren anë;

dhe

NTSH ELEKTRO AM (në vazhdim "Operatori Ekonomik" ose OE), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

"Furnizim me ndërprerës të tensionit të mesëm" me numër Identifikues RFQ 11/01

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Furnizim me ndërprerës të tensionit të mesëm me numër Identifikues RFQ 11/01

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 19.02.2020 dhe përfundon me dorëzimin e materialit nga ana e OE dhe pranimit nga AK.

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 50 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë *depo qendrore KEDS*.

1.5 Kontraktuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin e përkohshëm në destinacion. Furnizimet duhet të pakëtohen në atë mënyrë që të parandalohet dëmi ose keqësimi i tyre gjatë transportit deri në destinacion. Paketimi do të jetë në bazë të standardeve ndërkombëtare që mundëson ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e sigurt që të mos vije deri te defektet e mallit. Paketimi do të bëhet pronë e Punëdhënësit dhe i njëjti së bashku me mallin nuk duhet të jetë i dëmshëm për ambientin.

1.6 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4,708.20 €; (katër mijë e shtatëqind e tetë Euro e njëzet Cent)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 60 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Pagesat që duhet të bëhen nga Punëdhënësi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Ofertën e Kontraktuesit, apo të dhënë si njoftim nga Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

4.4 Kontraktuesi duhet t'i përcjellë Punëdhënësit për secilin liferim të bërë, faturën.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Fatura (Origjinali i faturës dhe një kopje) do t'i dërgohet direkt Punëdhënësit.
Fatura duhet të përmbajë informatat e mëposhtme :

- a) Referencën e numrit të kontratës dhe titulli i kontratës;
- b) Adresën e pranimit në vendndodhje nga Punëdhënësi;
- c) Përshkrimin e mallrave të pranuar nga Punëdhënësi;
- d) Sasinë e pranuar, çmimin e njësisë, dhe totalin;
- e) Datën e liferimit;
- f) Datën e faturimit;
- g) Pa kompletimin e dokumenteve të lartë cekura fatura nuk mund të procedohet për pagesë.

4.5 Çdo faturë duhet pas verifikimit të njoftimit për liferim të furnizimeve nga ana e një përfaqësuesi të autorizuar të Punëdhënësit në destinim, së bashku me dokumentet mbështetëse ti dërgohet Punëdhënësit për të bërë pagesën, dhe të gjitha këto duhet të adresohen tek adresa e Punëdhënësit.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *furnizimeve*.

7.2 Kontraktuesi garanton që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe në material. Kontraktuesi garanton edhe që asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën themelore Prishtinë në pajtim me ligjet e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin i identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip² dhe Angleze në dy origjinale, një origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Emri: *Migjen Bexhiri*
Pozita: *Drejtor*
Nënshkrimi: *Drejtor*
Data:
Vula:



Për Autoritetin Kontraktues

Emri: Alpin DOGAN
Pozita: Drejtor Ekzekutiv i Rrejetit
Nënshkrimi: *[Signature]*
Data:

Emri: Adem SOPA
Pozita: Zyrtar i Prokurimit
Nënshkrimi: *[Signature]*
Data:

Emri: Ferit TUFAN
Pozita: Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi: *[Signature]*
Data:

Emri: Alper ERBAS
Pozita: Drejtor Gjeneral i KEDS
Nënshkrimi: *[Signature]*
Data:



² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.